



*Arsyetimi*

Agjencia kundër Korruptionit (në tekstin e mëtejmë Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njostimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 15 korrik 2020, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-1571/20*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: “**Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në sh.m.e “Kadri Kusari” Gjakovë**” me numër të prokurimit: 632/20/3579/521, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike, të llojit punë, me vlerë të mesme të parashikuar prej 249,932.32 €.

Në kuadër të rubrikës III.2.4. Kapaciteti teknike dhe profesionale kërkesa 2, Agjencia vëren se, Autoriteti kontraktues *ka kërkuar nga operatorët ekonomik të ofrojnë dëshmi se kanë së paku 20 (njëzet) punëtor të mjaftueshëm si dhe të kenë staf profesional për kryerjen e projektit ku të gjithë duhet të jenë në listën e ATK-së*. Kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.

Sipas dispozitave të Ligjit në fuqi për prokurimin publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, autoriteti kontraktues mund të kërkojë minimumin e mesatares së fuqisë punëtore dhe stafit menaxherial për secilin nga 3 vitet e fundit, ku si dëshmi mund të kërkojë një deklaratë apo raport për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e kaluara.

Agjencia kundër Korruptionit konsideron se një kërkesë e tillë e vendosur nga Autoriteti kontraktues është diskriminuese dhe nuk u mundëson operatorëve tjerë të cilët kanë një numër minimal të fuqisë punëtore të ofertojnë për ketë kontratë. Duke caktuar një kufizim të tillë autoriteti kontraktues favorizon vetëm operatorët ekonomik të cilët kanë këtë numër të të punësuarve ose më tepër dhe në këtë mënyrë i eliminon operatorët tjerë të cilët kanë një numër të kënaqshëm të të punësuarve. Duke caktuar një kërkesë të tillë autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik, ku sipas këtij ligji thuhet se “*Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrëthanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik*“.

Agjencia kundër Korruption, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim dhe Jo-diskriminimi, si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njostimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*